

UDHËZIM
Nr.10 datë 17.8.1993

PËR PROKURIMIN ME FONDE SHTETËORE NË PROJEKTIMIN DHE ZBATIMIN E
NDERTIMEVE PUBLIKE

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

I. PëRKUFIZIME

1. Ndërtime publike janë të gjitha veprimtaritë e ndërtimit, prishjes, rikuperimit e ristrukturimit të objekteve të financuara nga subjekte publike.
2. Sipërmarrësi është personi juridik vendas a i huaj që merr përsipër zbatimin e ndërtimit publik.

II. RREGULLA Të PëRGJITHSME

1. Organizimi i procedurave të përgjithshme të prokurimit për projektimin dhe sipërmarrjen e zbatimit të ndërtimeve publike bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.467, datë, 17.8.1993 "Për procedurat e prokurimit me fonde shtetërore".
2. Procedurat dhe kushtet e veçanta që duhen zbatuar për prokurimin e projekteve dhe sipërmarrjes për zbatimin e ndërtimeve publike përcaktohen në këtë udhëzim.

III. PROJEKTIMI

1. Procedura e prokurimit shpallet për skicidete dhe projektidete.
Skicideja përmban studimin e problemeve që për natyrën e tyre lejojnë mjaft mundësi zgjidhjesh. Në këtë lloj procedure prokuruese pjesëmarrësit duhet të paraqesin ide dhe propozime nëpërmjet një relacioni të ilustruar me vizatime të përgjithshme ose skica.
Projektideja përmban studimin e zgjidhjes më të mirë të një problemi të përcaktuar. Pjesëmarrësit duhet të paraqesin vizatimet grafike të nevojshme për të dhënë njohuri të sakta karakteristikave kryesore të ndërtimit, të shoqëruar me një relacion preventiv paraprak.
2. Ndërtime me rëndësi të veçante mund të shpallen konkurse me dy shkallë. Konkursi i shkallës së parë bën përzgjedhjen e projekteve të paraqitura dhe i kalon projektet e zgjedhura për miratim në shkallën e dytë, duke bërë vlerësimin sipas kriterëve të përcaktuara.
3. Në konkurset për projekte mund të marrin pjesë të gjithë personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, të pajisur me licencë projektimi në përshtatje, me llojin e ndërtimit publik që do të projektohet.
4. Kur në konkurs marrin pjesë konkurrentë të bashkuar në grupe projektimi, njëri prej tyre duhet të ketë të drejtën e përfaqësimit ligjor të grupit në marrëdhëniet me subjektin publik që ka shpallur konkursin.
5. Personave të interesuar për konkursin, me kërkesat e tyre, do t'u jepen të dhënat e nevojshme për hartimin e projektit kundrejt pagesës. Të dhënat do të jenë të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit.
6. Paraqitja grafike e projektit duhet të bëhet në bazë të përmasave dhe shkallës së kërkuar nga subjekti që organizon konkursin.
Kur është i nevojshëm krahasimi i kostos ndërmjet disa projekteve, kërkohet paraqitja e preventivave përkatës bashkë me llogaritë metrike, me çmimet baze të dhëna nga subjekti publik.

7. Për përgatitjen e projekteve fiksohet një afat, sipas rëndësisë së objektit dhe vështirësive relative të projektimit.

Afati fillon nga data e nesërme e shpalljes së konkursit dhe nuk duhet të jetë më i vogël se 30 ditë.

Projektet që sillen pas skadimit të afatit, nuk shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit Ato ruhen deri në 60 ditë nga dita e publikimit të përfundimeve të konkursit. Pas këtij afati subjekti publik nuk përgjigjet për projektet që nuk janë tërhequr.

8. Shpenzimet për zhvillimin e konkursit janë në ngarkim të subjektit publik që shpall konkursin.

9. Pagesa e çmimit të projektit fitues i jep subjektit publik të drejtën e pronësisë mbi projektin.

10. Subjekti publik, kur vendos të hartojë projektzbatimin e objektit, është i detyruar që këtë detyrë t'ia japë fituesit të konkursit për projektidenë.

11. Hartimi i projektzbatimit bëhet mbi bazën e një kontrate të lidhur ndërmjet palëve, ku do të përcaktohen kushtet, afatet dhe mënyra e pagesës.

Pagesa është e njëjtë si për projektuesin e vetëm, ashtu është për një grup projektuesish.

12. Nëse subjekti publik vendos të caktojë një drejtues të jashtëm të punimeve, atëherë në këtë detyrë do të paraqitet fituesi i konkursit.

13. Në fund të konkursit të shkallës së parë komisioni shpreh vlerësimin e tij të motivuar mbi projektet dhe harton, pa bërë klasifikimin, një listë të projekteve për t'u kaluar në shkallën e dytë, duke formuar dhe sugjerimet e nevojshme.

Konkursi i shkallës së dytë dhe data e paraqitjes së punimeve, si dhe të dhënat e tjera plotësuese, u komunikohen konkurrenuesve të pranuar me shkrim.

14. Për çdo konkurrim mund të jepen deri në 3 çmime. Vlerësimi i çmimeve mund të jetë deri në 0.5 për qind e vlerës së ndërtimit për çmimin e parë, deri 0.3 për qind për çmimin e dytë dhe deri 0.2 për qind për çmimin e tretë.

Shpenzimet e mundshme të pagueshme nga subjekti që shpall konkursin për projektin fitues, janë deri në 300 000 lekë.

15. Konkursi mund të mos organizohet vetëm kur:

- projekti është tip ose i përdorur edhe më parë;
- projekti nevojitet vetëm për një pjesë të ndërtimit publik;
- vlera e ndërtimit është më e vogël se 5 000 000 lekë.
- ndërtimi ka karakter strategjik ose sekret.

IV. SIPËRMARRJA

1. Procedurat prokuruese për sipërmarrjen e zbatimit të ndërtimeve publike mund të zhvillohen me këto mënyra:

- me çmim të fiksuar;
- me matje.

2. Fituesi i garës me çmim të fiksuar përcaktohet në baze të çmimit më të ulët të ofruar për përfundimin e ndërtimit me çelësa në dorë.

3. Fituesi i garës me matje përcaktohet në bazë të vlerës më të ulët të ofruar për çmimet njësi të materialeve dhe punimeve kryesore.

4. Kriteret të tjera vlerësimi mund të jenë:

-Afati i përfundimit të ndërtimit;

-vëllimi i punës që kryhet me fondet e dhëna, kur këto fonde nuk mjaftojnë për përfundimin e ndërtimit dhe shfrytëzimin e pjesshëm:

- vlera teknike e ndërtimit;
- cilësia e ndërtimit;

-teknologjia e përdorur në ndërtim.

5. Në realizimin e garave numri i pjesëmarrësve nuk mund të jetë më i ulët se 3 dhe jo më i lartë se 40.

Kur numri është i lartë se 40, subjekti publik që organizon garën bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve deri në këtë numër me short të hedhur në prani të gjithë pjesëmarrësve.

6. Në garë mund të paraqiten persona juridikë vendas e të huaj të pajisur me licencë, përkatësisht në përputhje me natyrën e ndërtimit publik që do të zbatohet.

7. Për të marrë pjesë në garat për sipërmarrjen e zbatimit të ndërtimeve publike, sipërmarrësit duhet të paraqesin një deklaratë, ku të vërtetojë se janë të njohur me terrenin e ndërtimit ku do të zhvillohen punimet, të jenë njohur me kushtet lokale, si dhe gjithë rrethanat e tjera që kushtëzojnë çmimet e materialeve, dhe të kenë rënë në një mendim për çmimet.

8. Për të marrë pjesë në garë, sipërmarrësi duhet të depozitojë garancinë e përkohshme në degën e bankës të përcaktuar në shpalljen e garës. Kjo garanci duhet të jetë nga 3 për qind deri 10 për qind e vlerës së ndërtimit. Kjo dispozitë duhet deri në përfundimin e garës.

V. KONTRATA E SIPËRMARRJES

1. Në çastin e nënshkrimit të kontratës duhet të dorëzohet garancia përfundimtare në mënyrën që caktohet në kushtet e kontratës. Kjo garanci duhet të jetë nga 3 për qind deri 10 për qind e vlerës së ndërtimit. Garancia depozitohet në degën e bankës së përcaktuar në kontratë. Në këtë rast mund të bëhet transferimi i garancisë së përkohshme në garanci përfundimtare.

2. Nënshkrimi i kontratës së sipërmarrjes bëhet brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së fituesit dhe njoftimit për pranimin e ofertës.

3. Sipërmarrësi në kontratë duhet të përcaktojë adresën e saktë ku do t'i dërgohen të gjithë njoftimet, dokumentacioni dhe çdo e dhënë tjetër që ka lidhje me kontratën.

4. Kontrata e sipërmarrjes duhet të përmbajë:

- a) kushtet e përgjithshme të kontratës;
- b) kushtet specifike të sipërmarrjes;
- c) projektzbatimin e ndërtimit publik;
- ç) degën e bankës dhe modalitetet e veprimeve bankare.

5. Janë në ngarkim të sipërmarrësit të gjitha shpenzimet e kontratës dhe të dokumenteve të tjera të hartuara për këtë qëllim deri në përfundim të ndërtimit.

6. Në rast se me fituesit e garës nuk lidhet kontrata në afatin e parashikuar në këtë ligj, subjekti publik ka të drejtë të lidhë kontratën me fituesin e vendit pasardhës në garë.

VI. ZBATIMI I NDËRTIMIT

1. Punimet e ndërtimit duhet të fillojnë jo më vonë se 45 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Në rastet e financimit nga kreditë dhe ndihmat e huaja, afati i fillimit të punimeve mund të përcaktohet në kontratë.

Nëse sipërmarrësi nuk paraqitet ditën e caktuar, i lihet një afat tjetër me skadimin e të cilit subjekti publik mund të zgjidhë kontratën. Me zgjidhjen e kontratës bëhet konfiskimi i garancisë.

Nëse punimet nuk fillojnë për faj të subjektit investitor, sipërmarrësi mund të heqë dorë nga kontrata. Në rastin e pranimit të dorëheqjes, sipërmarrësi ka të drejtën e kthimit të shpenzimeve të bëra efektivisht nga ai.

2. Sipërmarrësi mund të përfaqësohet me prokurë nga një person i caktuar prej tij. Sipërmarrësi është përgjegjës për veprimet e përfaqësuesit të tij.

Emri i përfaqësusit i komunikohet drejtuesit të punimeve.

Subjekti publik investitor ka të drejtë të kërkojë nga sipërmarrësi ndërrimin e menjëhershëm të përfaqësuesit të tij, pa pasur nevojë të motivojë kërkesën e tij.

3. Sipërmarrësi gjatë zbatimit të punimeve në përputhje me kontratën duhet të ndodhet vazhdimisht pranë objektit që ndërtohet dhe të zbatojë urdhërat dhe instruksionet që i jepen me shkrim nga drejtuesi i punimeve. Ai ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me urdhërat dhe instruksionet e drejtuesit.

4. Sipërmarrësi nuk mundet për asnjë arsye të ndërhyjë me nismën e tij për të bërë ndryshime në punimet që ka marrë përsipër.

Ai është i detyruar të zbatojë brenda kriterëve ndryshimet e paraqitura e të urdhëruara nga subjekti publik investitor, por që nuk ndryshojnë thelbësisht kushtet e kontratës.

Urdhërat për ndryshime jepen me shkrim nga drejtuesi i punimeve dhe me miratim të subjektit publik investitor.

Në rastet e urgjencës, drejtuesi i punimeve mund të urdhërojë me shkrim zbatimin e menjëhershëm të ndryshimit.

Ndryshimet vlerësohen me çmimet e kontratës. Në rast se duhet të zbatohen punime të paparashikuara në kontratë ose të përdoren materiale, për të cilat nuk ka çmime në kontratë, atëherë vendosen çmime të reja.

5. Subjekti publik investitor, gjatë zbatimit të punimeve, mund të urdhërojë me të njëtat kushte të kontratës një rritje ose pakësim të punimeve deri në 20 për qind të vlerës së nënshkruar në kontratë, pa iu detyruar asnjë kompensim sipërmarrësit.

Në rast se këto punime janë mbi 20 për qind e vlerës së caktuar në kontratë dhe sipërmarrësi nuk është dakord me kompensimin, sipërmarrësit i lind e drejta të kërkojë në rrugë gjyqësore zgjidhjen e kontratës. Subjekti publik investitor është i detyruar t'i paguajë sipërmarrësit vlerën e punimeve të kryera të vlerësuara me çmimet e kontratës.

Kur sipërmarrësi bie dakord për ndryshimet e propozuara, vendose nëse nevojitet, një afat i ri i përfundimit të punimeve.

Kur është realizuar 80 për qind e vlerës së kontratës, nuk lejohet të bëhen ndryshime në kushtet e kontratës.

6. Sipërmarrësi ka të drejtë të angazhojë nën përgjegjësinë e tij persona të tretë për kryerjen e punimeve të veçanta, të cilat nuk mund t'i kryejë vetë. Detyrimet dhe përgjegjësitë për këtë angazhim përcaktohen në kontratë.

7. Sipërmarrësi përgjigjet për rregullin në kantier dhe ka për detyrë të zbatojë e të bëjë të zbatueshëm nga personeli i tij të gjitha dispozitat ligjore e nënligjore.

Drejtori i punimeve ka të drejtë të kërkojë largimin nga puna e drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi a pakujdesi të rënda.

Sipërmarrësi në të gjitha rastet është përgjegjës për dëmet që shkaktohen nga mungesa e përvojës ose pakujdesia e personelit të tij, si dhe keqtrajtimi ose abuzimi në përdorimin e materialeve.

8. Me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në kontratë, janë në ngarkim të sipërmarrësit: shpenzimet për krijimin dhe mbajtjen e kantierëve dhe ndriçimi; shpenzimet për transportin e materialeve e makinerive; shpenzimet për pajisjet, skelat dhe çdo gjë tjetër që nevojitet për realizimin e objektit; shpenzimet për rivelimet, piketimet, verifikimet, ekspertimentimet që nga fillimi gjer në përfundimin e kolaudimit; shpenzimet të përkohshme, për rrugë ose hekurudha shërbimi; shpenzimet për zënie të përkohshme të tokës e prerje të drurëve, për depozita e kavo materialeve; shpenzimet për ruajtjen e objekteve; shpenzimet doganore dhe shpenzime të tjera që nevojiten për realizimin e objektit.

Sipërmarrësi duhet të sigurojë materialet dhe mjetet që kërkohen nga drejtuesi i punimeve për realizimin e veprës. Me çmimet e kontraktuara sipërmarrësi duhet të mirëmbajë makineritë dhe ngritjen e kantierit.

9. Sipërmarrësi merr masat për shmangien e dëmeve në personel, objekt dhe mjete gjatë periudhës së ndëtim, si dhe bën sigurimin ndaj këtyre dëmeve.

Sipërmarrësi duhet të zbatojë normat e parashikuara në kontratën kolektive të punës, ligjet dhe rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjen në punë, sigurimet shoqërore dhe asistencën e

punëtorëve.

10. Materialet duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kontratës. Ato mund të përdoren në vepër vetëm me miratimin e drejtuesit të punimeve. Materialet e ardhura në kantier dhe që nuk pranohen nga drejtuesi i punimeve, zëvendësohen me të tjera me shpenzimet e sipërmarrësit.

Kur sipërmarrësi përdor në vepër me nismën e tij materiale me cilësi më të lartë se ajo e përshkruar ose në një punim më të kushtueshëm, nuk ka të drejtë të kërkojë rritjen e çmimeve të vendosura në kontratë.

Nëse subjekti publik investitor lejon shmangie në përmasa ose cilësi më të dobët, drejtuesi i punimeve, gjithmone kur vepra është e pranueshme, mund të zbatojë një zbritje të çmimeve si kontabilitet dhe si vlersim përfundimtar në kolaudim.

Drejtuesi i punimeve mund të vendosë të bëjë prova të materialeve për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.

Sipërmarrësi është i lirë të zgjedhë personin fizik a juridik, ku do të sigurojë materialet por gjithmonë brenda përshkrimeve të kontratës.

Në çmimin e materialeve parashikohen gjithë shpenzimet dhe të ardhurat e sipërmarrësit për furnizimin deri në objekt, duke përfshirë shpenzimet për hapjen e kavove, nxjerrjen e materialeve dhe zënien e përkohshme të tokës.

Me kërkesë të subjektit publik investitor sipërmarrësi duhet të vërtetojë që ka vepruar sipas ligjeve për shpronësimet për nevoja publike, si dhe për pagesat që ka bërë për zëniet e përkohshme të tokës.

11. Sipërmarrësi duhet të prishë e ribëjë me shpenzimet e veta punimet e bëra jo me cilësinë e parashikuar ose me materiale jo sipas përshkrimit, kur urdhërohet nga drejtuesi i punimeve.

Kur drejtuesi i punimeve mendon se ka defekte në konstruksion, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë drejtuesit të punimeve, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtën e shlyerjes së shpenzimeve.

12. Kur ka dëme nga forca madhore, këto duhet denoncuar nga sipërmarrësi brenda 5 ditëve nga data e ndodhjes.

Kompensimi i këtyre dëmeve kufizohet me punimet për rivendosjen e gjendjes së mëparshme me çmimet e kontratës.

Kompensim nuk jepet kur dëmet vijnë për faj të sipërmarrësit ose të personave që ai ka ngarkuar.

Kompensim nuk jepet as për materialet e papërdorura në vepër.

13. Nëse nuk është parashikuar ndryshe në kontratë, sasitë e punimeve bëhen me matje gjeometrike, duke përjashtuar çdo metodë tjetër.

14. Sipërmarrësi duhet t'i mbarojë punimet në afatin e caktuar në kontratë. Sipërmarrësi për kohën jashtë afatit të përcaktuar, me përjashtim të rasteve kur vonesat nuk janë për faj të tij, duhet t'i paguajë subjektit publik investitor shpenzimet e bëra për këtë qëllim, si dhe kushtin penal që përcaktohet në kontratë për çdo ditë vonesë.

Përfundimi i punimeve i njoftohet me shkrim drejtuesit të punimeve.

Sipërmarrësi nuk ka të drejtë të zgjidhë kontratën në asnjë rast kur ka kaluar afati i përfundimit të punimeve për faj të tij, pavarësisht nga koha që ka kaluar.

Në rast se afati është shkelur për faj të subjektit publik investitor, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës pa kërkuar kompensim.

Në asnjë rast zgjatja e pezullimit nuk llogaritet në afatin e fiksuar për përfundimin e veprës.

Rifillimi i punimeve bëhet me urdhër me shkrim të drejtuesit të punimeve.

16. Sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shtyrje të afatit, në rast se për arsye që nuk varen prej tij, nuk është në gjendje të përfundojë punimet sipas kontratës. Shtyrja e afatit kërkohet me shkrim, përpara mbarimit të tij, duke motivuar arsyet e kërkesës.

17. Gjatë zbatimit të punimeve në bazë të situacioneve që paraqiten, sipërmarrësit i bëhen pagesat përkatëse, sipas përcaktimeve të bëra në kontratë.

Mbi të ardhurat e punimeve zbatohen taksat sipas ligjit.

18. Kërkesa për pagimin e punimeve të kryera hartohet nga sipërmarrësi dhe shoqërohet me situacionin e punimeve me njësi, sasi, çmim dhe vlerë të punës së kryer.

Për parafabrikate të veçanta, vlera e të cilave është më e madhe se vlera e vendosjes në vepër, në pika të veçanta të kontratës mund të caktohen edhe çmime të punimit në proces gjithnjë jo më shumë se 50 për qind e çmimit total.

Materialet dhe parafabrikatet që vendosen në ndërtim si punim në proces mbeten në ngarkim të sipërmarrësit dhe mund të refuzohen në çdo kohë, nëse nuk janë të përshtatshme nga drejtuesi i punimeve.

19. Në rast se situacioni nuk likuidohet nga subjekti publik investitor në afatin e caktuar në kontratë, sipërmarrësi gëzon të drejtën e përfitimit të interesave mbi shumën e papaguar. Nëse kjo zgjat edhe 30 ditë të tjera, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë në rrugë gjyqësore zgjidhjen e kontratës dhe pagimin e detyrimeve nga subjekti publik investitor.

20. Për ndërtimet që vazhdojnë më shumë se një vit, në fund të çdo viti bëhet bilanci vjetor.

21. Materialet që dalin nga prishjet, mbeten në pronësi të subjektit publik investitor, nëse nuk është parashikuar ndryshe në kontratë.

Sipërmarrësi duhet të transportojë e t'i depozitojë ato në vendin e caktuar, duke u kompensuar me çmimet përkatëse.

Kur në kontratë vendoset që materialet e rikuperuara nga prishjet do t'i kalohen sipërmarrësit, vlera e tyre zbritet nga vlera e plotë e ndërtimit.

VII. KOLAUDIMI I NDËRTIMI

1. Me përfundimin e punimeve dhe jo më shumë se një muaj nga data e deklarimit të përfundimit, duhet të bëhet kolaudimi i ndërtimit.

Me kolaudimin e ndërtimit synohet të verifikohet e të vërtetohet që;

a) ndërtimi është realizuar në përputhje me projektin dhe kushtet teknike;

b) ndërtimi është realizuar në përputhje me kontratën.

c) të dhënat nga matjet dhe dokumentet përputhen në përmasa, formë, sasi e cilësi;

ç) çmimet e zbatuara dhe kompensimet janë bërë në përputhje me kontratën.

Në aktin e kolaudit ekzaminohen edhe kërkesat e sipërmarrësit, të cilat, megjithëse janë paraqitur me shkrim nga ai sipas afateve dhe rregullave të caktuara, nuk janë shqyrtuar e marrë parasysh. Asnjë kërkesë tjetër nuk do të merret parasysh.

2. Sipërmarrësi me përfundimin e punimeve paraqet te drejtuesi i punimeve:

a) kontratën dhe aktet e tjera të lidhura me të;

b) regjistrin e kontabilitetit;

c) procesverbalet e dhënies, ndërprerjes, zgjatjes dhe përfundimit të punimeve;

ç) kërkesat e tij.

Këto, bashkëlidhur me relacionin e drejtuesit të punimeve, i dërgohen nga ky i fundit subjektit publik investitor.

Me marrjen e këtyre dokumenteve subjekti emëron kolaudatorin ose grupin e kolaudit, të cilit i dorëzon dokumentet e mësipërme.

Nuk lejohet emërimi si kolaudator i një personi që ka sadopak lidhje me projektin, zbatimin ose drejtimin e punimeve.

Kolaudatori ose grupi i kolaudit mund të emërohen edhe para përfundimit të veprës, që të kenë mundësi të bëjnë verifikime të nevojshme.

Kolaudatorit i dorëzohen edhe:

a) kopje e plotë e projektit dhe ndryshimet e mundshme të tij;

b) gjithë dokumentet kontabël ose justifikuese që mund të kërkohen.

3. Kolaudatori fikson datën e fillimit të procedurës së kolaudimit dhe ia komunikon me shkrim drejtuesit të punimeve dhe sipërmarrësit, duke mbajtur kopje të vërtuar të njoftimit.

Verifikimi behet aq sa kolaudatori e gjykon të mjaftueshëm për të formuar bindjen që të gjitha pjesët e veprës dhe kontabiliteti janë plotësisht në rregull.

4. Sipërmarrësi duhet, me kujdesin dhe shpenzimet e veta, të vërë në dispozicion të kolaudorit punëtorët dhe mjetet që i kërkohen për të bërë verifikimet, eksperimentimet dhe gjithçka tjetër të nevojshme të kërkuar nga kolaudatori.

Kur sipërmarrësi plotëson detyrimet e mësipërme, kolaudatori urdhëron që këto të kryhen me shpenzimet e subjektit publik investitor, shpenzime që i zbriten të ardhurave të sipërmarrësit.

5. Procesverbali i kolaudimit duhet të përmbajë:

a) vendndodhjen e ndërtimit;

b) emërtimit

c) datën dhe prejardhjen e projektit, si dhe ndryshimeve a plotësimeve të tij;

ç) datën e kontratës dhe akteve të tjera lidhur me këtë, si dhe datat e miratimit të tyre;

d) vlerën e vënë në dispozicion;

dh) identitetin e sipërmarrësit;

e) datat e procesverbaleve të garës dhe përfundimit të punimeve;

ç) kohën e vënë në dispozicion për zbatimin e ndërtimit, si dhe shtyrjet e mundshme të afatit;

f) vlerën e përgjithshme të shpenzimeve;

g) datën e emërimit, emrin e mbiemrin e kolaudatorit dhe specialitetin.

gj) ditët e zgjatjes së kolaudimit;

h) emrin, mbiemrin e pjesëmarrësve në kolaudim dhe të atyre që munguan.

Në procesverbal përshkruhen verifikimet e bëra dhe rezultatet e arritura. Në projekt shënohen pikat ku janë bërë sondazhet.

Procesverbali firmoset nga kolaudatori, sipërmarrësi dhe drejtuesi i punimeve.

6. Deri në miratimin e aktit të kolaudimit, subjekti politik investitor mund të organizojë një kolaudim të ri dhe akti i mëparshëm nuk është më i vlefshëm.

Kolaudimi i një vepre dhe miratimi i saj nuk e çliron sipërmarrësin nga detyrimet që rrjedhin nga kontrata dhe dispozitat ligjore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi